




REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E DRENASIT
Zyra e Kryetarit
Nr. _____/2013



RAPORT I BUXHETIT TË KOMUNËS
PËR VITIN 2012

DRENAS, Shkurt 2013

RAPORTI VJETOR I BUXHETIT
Janar - Dhjetor /20112

1

Baza e përgatitjes.

Raporti është përgatitur në pajtim me LMFPP (03/L-048) të ndryshuar me ligjin 04/L-221 , dhe SNKSP e bazuar në para të gatshme - Raportimi financiar sipas parimit të kontabilitetit të bazuar në para të gatshme Baza e kontabilitetit dhe raportimit tani më në Kosovë sipas LMFPP është baza e parasë së gatshme. Në këtë bazë , informatat e prezantuar në këtë raport paraqesin pranimet dhe pagesat e parasë së gatshme. Menagjimi i parasë i organizuar në formën e llogarisë së vetme të Thesarit. Llogaria e vetme e thesarit është sistem llogarish bankare që shfrytëzohen për mbledhjen e të hyrave dhe realizimin e shpenzimeve të cilat i kontrollon një institucion i vetëm - Departamenti i Thesarit.

Politikat kontabel janë zbatuar në mënyrë të vazhdueshme gjatë tërë vitit fiskal.

Ligji nr.03/L-048 për MFPP, përkatësisht neni 45.4 kërkon që kryetari i komunës të përgatit dhe t'i dorëzoi kuvendit komunal raportet periodike dhe përfundimtare të cilat mbulojnë vitin fiskal i cili sapo ka përfunduar, këto raporte më pas publikohen në faqen zyrtare të komunës me qëllim të përmbushjes së principit të transparencës

Ndarjet Buxhetore

Ligji nr.04/L-079 i paraqet ndarjet buxhetore për vitin fiskal 2012. Ky ligj përfshinë edhe mekanizma që mundësojnë ndryshime të këtyre ndarjeve buxhetore gjatë vitit, këto mekanizma përfshijnë:

- * Ndarjen buxhetore të disa llojeve të të hyrave vetanake të mbledhura nga fushat kryesore të të hyrave në vitin paraprak e të pa shpenzuara ;
- * Ndarjen buxhetore nga të hyrat vetanake të planifikuara për arkëtim gjatë vitit 2012 sipas fushave Kryesore të të hyrave dhe sipas sektorëve kryesor ;
- * Ndarjen buxhetore nga grantet nderqeveritare sipas programeve - nënprogrameve , si dhe
- * Ndarjen buxhetore nga grantet e donatorve.

1.Ndarjet fillestare buxhetore sipas Ligjit nr.04/L- 079 , shprehur në euro (€)

Nr	Programet	Pag&Mëdit	Mall&Sherb	Sh Komunal	Subvencione	Shp.Kapitale	Totali	Stafi/12
1	Z.Kryetarit	72,141.00	33,500.00	1,500.00	20,000.00	25,000.00	152,141.00	10
2	Administrata dhe pers	151,721.00	100,000.00	35,000.00	5,000.00	25,000.00	316,721.00	40
3	D.Inspekcionit	43,817.00	15,870.00	360.00		-	60,047.00	9
4	Z Kuvendit	95,349.00	5,000.00	360.00	-	-	100,709.00	1
5	D.Buxhet dhe Financa	61,295.00	10,000.00	360.00	-	20,000.00	91,655.00	14
6	D.Sh.Pub.Infrarug	104,172.00	38,253.00	2,790.00	10,000.00	175,000.00	330,215.00	23
7	Z.Kom. Dhe kthim	5,946.00	3,730.00	360.00	-	-	10,036.00	1
8	D.Bujqësisë	53,571.00	10,000.00	360.00	7,774.00	86,000.00	157,705.00	13
9	D.Gjeodezi	55,049.00	8,510.00	360.00	-	72,000.00	135,919.00	12
10	D.Urbanizmit	42,486.00	10,000.00	360.00	-	1,650,508.00	1,703,354.00	9
11	D.Kultures	53,154.00	27,050.00	360.00	50,000.00	70,000.00	200,564.00	12
12	S.Shendetësisë	943,951.00	200,000.00	42,000.00	15,000.00	100,000.00	1,300,951.00	200
13	S.Arsimit	4,295,484.00	335,066.00	59,934.00	20,000.00	150,000.00	4,860,484.00	963
	Gjithsej:	5,978,136.00	796,979.00	144,104.00	127,774.00	2,373,508.00	9,420,501.00	1,307

Tabela e lartëshenuar paraqet buxhetin fillestar për Komunën e Drenasit i shprehur në vlerë financiare prej:9.420.501.00 € të financuar nga dy burime të të hyrave dhe të shpërndar në programe dhe kategori kryesore ekonomike të shpenzimeve . Burimet kryesore të të hyrave janë:

- a) Granti qeveritar në shumë prej:8.616.273.00 € apo shprehur në përqindje 91.46 %
- b) Të hyrat vetanake në shumë prej:804.228.00 € apo shprehur në përqindje:8.54 %.

Shpërndarja e buxhetit sipas tabelës së lartëshenuar është bërë për nga karakteri funksional në 13 programe; ndërsa për nga karakteri ekonomik në 5 kategori kryesore ekonomike të shpenzimeve.

Zhvillimi dhe analiza e Buxhetit Komunal për vitin 2012

Raporti financiar paraqet një pasqyrë të bilancit për të hyrat dhe të dalat- shpenzimet të realizuara në raport me planifikimin për këtë të dhënat përmblendhëse për vitin 2012 do të pasqyrohen në tabelën e më poshtme.

2

2.Skema buxhetore për vitin 2012

Përshkrimi	Planifikimi	Alokimi	Shpenzimi	% Planit	% Alokimit
Granti	9,116,273.00	9,116,106.21	9,008,223.58	98.81	98.82
Burimet Vetanake 2012	804,228.00	804,228.00	611,792.77	76.07	76.07
Burimet vetanake 2011	411,806.24	411,806.24	285,496.78	69.33	69.33
Donacionet 2012	19,992.42	19,992.42	18,770.44	93.89	93.89
Raporti përmblendhës	10,352,299.66	10,352,132.87	9,924,283.57	95.87	95.87


Tabela e lartëshenuar paraqet zbatimin e buxhetit komunal 2012 për nga burimet e financimit si për të hyrat e po ashtu dhe për të dalat publike. Nëse bëjmë një krahasim të buxhetit fillestar (9.420.501.00 €) dhe atij përfundimtar të akorduar në shumë prej: 10.352.132.87 €, del se kemi patur një zhvillim pozitiv për + 9.88 % . Shpenzimi i buxhetit të rishikuar (10.352.299.66 €) është realizuar në përqindje 95.87% ; ndërsa krahasuar me alokimin % e shpenzimit të buxhetit është realizuar 95.87 % . Vlenë të theksohet se Grantet Qeveritare janë shfrytëzuar në përafersisht në përqindje prej 98.82. Të hyrat nga burimet vetanake dhe Donacionet e vitit 2011 janë bartur 100% dhe janë shpenzuar përafersisht në përqindje prej 69.33 , dhe 93.89 % ; ndërsa të hyrat nga burimet vetanake të vitit 2012 të alokuara janë shpenzuar 76.07 % , këtu mungojnë të dhënat e të hyrave nga burimet vetanake të arkëtuara e të pa alokuara . Derisa të hyrat e burimeve vetanake të vitit 2012 janë realizuar në shum prej : 868.357.83 € apo + 7.97% mbi planin vjetor , të njëjtat kan mbetur ta pa alokuara në shumë prej: 64,129.83 € e të cilat do të alokohen si bartje në vitin fiskal 2013. Marr në tërësi të hyra nga burimet vetanake që konsiderohen si saldo - bilanc bankar për bartje në vitin fiskal 2013 janë në shumë prej : 382.874.52 € .

Tabela 3. Të hyrat e burimeve vetanake janar - dhjetor 2012.

Nr	Fushat e të hyrave	Planifikimi	Realizimi	Përqindja
1	Certifikata e lindjes	47,000.00	37,774.00	80.37
2	Certifikata e Kunorës	15,820.00	8,916.00	56.36
3	Certifikata e Vdekjes	1,710.00	122.00	7.13
4	Certifikata e tjera ofiqare	18,662.00	9,408.00	50.41
5	Fotokopje dokumentacionit	6,000.00	3,600.50	60.01
6	Kërkesat	3,000.00	2,305.50	76.85
7	Qeraja e objektev komunale	23,617.00	10,960.92	46.41
	Tot.drejt.administrates	115,809.00	73,086.92	63.11
8	Tatimi në pronë	172,000.00	239,444.92	139.21
9	Tax për regjistrim të automjeteve	22,051.00	65,990.00	299.26
10	Transfer Prone	5,085.00	15,701.00	308.77
	Tot. për Buxhet dhe Financa	199,136.00	321,135.92	161.26
11	Taxa në firma	131,500.00	117,096.00	89.05
	Tot. I Bujq.dhe zhvill rural	131,500.00	117,096.00	89.05
12	Tax për regjistrim prone	8,159.00	40,281.00	493.70
13	Tax për Flet poseduese dhe kop.pl	8,000.00	14,433.50	180.42
14	Matje Gjeodezike	22,000.00	13,014.00	59.15
	Tot. I Gjeodezisë	38,159.00	67,728.50	177.49
15	Tax parkingu	5,300.00	1,752.00	33.06
16	Tax për leje ndertimi	66,430.00	66,319.39	99.83
	Tot.Urbanizmi	71,730.00	68,071.39	94.90
17	Gjobat nga Inspekcioni	24,894.00	30.00	0.12
	Gjithsej administrata	581,228.00	647,148.73	111.34
18	Gjobat nga Gjykatat	60,000.00	106,360.00	177.27
19	Gjobat nga Trafiku	30,000.00	17,932.00	59.77
	Te hyrat direkte-indirekte	90,000.00	124,292.00	138.10
I	Totali i Administratës	671,228.00	771,440.73	114.93
20	Participimi shend.	70,000.00	38,780.50	55.40
	Gjithsej Shendetësia	70,000.00	38,780.50	55.40
21	Participim Qerdhja	30,000.00	21,657.25	72.19
22	Participim Sh.M. F. Lladrovci	33,000.00	36,479.35	110.54
	Gjithësej Arsimi	63,000.00	58,136.60	92.28
III	R.përmblendhës (I+II+III)	804,228.00	868,357.83	107.97

Tabela e lartëshenuar paraqet planifikimin dhe arkëtimin e të hyrave nga burimet vetanake për periodën Janar-Dhjetor 2012, sipas sektorve kryesor dhe fushave kryesore të të hyrave. Nëse bëjmë një krahasim në mes të planifikimit dhe arkëtimin të të hyrave vetanake , vërehet se planifikimi është tejkaluar për + 7.97 %.

Krahasuar me vitin paraprak (841.236.87) kemi një rritje për + 3.22 %, të hyra të arkëtuara.



Komuna i menagjon shpenzimet përmesë përdorimit të llogarisë së vetme të Thesarit (LVTH) e cila mbulohet në Autoritetin Bankar të Kosovës (AQBK) me këtë nr.1000650070000022.

Proqesi i shpenzimeve është i përfshir në disa koncepte kryesore lidhur me shpenzimin e parave publike dhe atë :

- * Ndarja buxhetore ,
- * Akordimi i fondeve,
- * Inicimi i shpenzimit,
- * Zotimi i fondeve,
- * Prokurimi,
- * Pagesa e faturës dhe
- * Lëshimi i fondëv nga llogaria bankare.

Për t'u bërë ngritja dhe promovimi i ekonomicitetit, efikasitetit dhe efektshmërisë të shpenzimit të parave publike, nga programet me kohë është bërë përgatitja e parashikimit paraprak të zotimeve dhe rrjedhës së parave së gatshme për vitin fiskal 2012. Ndarja e buxhetit në programe - nënprograme si dhe projekte ka patur një ndikim pozitiv në drejtim të realizimit të një menagjimi më të mirë dhe transparent të parave publike.

Shpenzimet ndahen për nga karakteri funksional në programe - nënprograme, ndërsa për nga karakteri ekonomik në pesë kategori kryesore ekonomike të shpenzimeve, zhvillimin e të cilave e pasqyrojnë tabelat në vijim:

Tabela.4. - Planifiki dhe realizimi i shpenzimeve - Sektori i Administratës Janar-Dhjetor/ 12

Nr	Pershkrimi	Pl Vjetor 2012	Alok 2012	Shpenzimi vjetor 2012	% ndaj planit	% ndaj Alok
1	Paga dhe Mëditje	738,701.00	740,090.00	704,906.43	95.43	95.25
2	Mallra dhe Shërbime	325,826.75	325,826.75	280,834.72	86.19	86.19
3	Shpenzimet e Shërb.Komunale	52,170.00	52,170.00	49,054.69	94.03	94.03
4	Subvencionet	110,774.00	110,774.00	104,787.09	94.60	94.60
5	Shpenzimet Kapitale	2,871,162.09	2,871,162.09	2,559,506.45	89.15	89.15
	Raporti përmbljedhës	4,098,633.84	4,100,022.84	3,699,089.38	90.25	90.22

Tabela .4.1 - Planifiki dhe realizimi i shpenzimeve - Sektori I Shendetësisë
Janar-Dhjetor/ 12


Nr	Pershkrimi	Pl. Vjetor 2012	Alok 2012	Shpenzimi vjetor 2012	% ndaj planit	% ndaj alok
1	Paga dhe Mëditje	943,951.00	942,896.55	942,686.34	99.87	99.98
2	Mallra dhe Shërbime	167,665.00	167,665.00	160,762.73	95.88	95.88
3	Shpenzimet e Sherb.Komunale	50,800.00	50,800.00	50,795.35	99.99	99.99
4	Subvencionet	15,000.00	15,000.00	14,996.97	99.98	99.98
5	Shpenzimet Kapitale	101,200.00	101,200.00	99,609.01	98.43	98.43
	Raporti përmbledhës	1,278,616.00	1,277,561.55	1,268,850.40	99.24	99.32

Tabela .4.2 - Planifikimi dhe realizimi i shpenzimeve - Sektori I Arsimit
Janar-Dhjetor/ 12

Nr	Pershkrimi	Pl Vjetor 2012	Alok2012	Shpenzimi vjetor 2012	% ndaj planit	%ndaj alok
1	Paga dhe Mëditje	4,337,428.15	4,330,030.10	4,367,206.64	100.69	100.86
2	Mallra dhe Shërbime	357,687.67	357,520.88	352,850.37	98.65	98.69
3	Shpenzimet e Sherb.Komunale	69,934.00	69,934.00	69,934.00	100.00	100.00
4	Subvencionet	50,000.00	50,000.00	49,999.98	100.00	100.00
5	Shpenzimet Kapitale	160,000.00	160,000.00	113,663.09	71.04	71.04
	Raporti përmbledhës	4,975,049.82	4,967,484.98	4,953,654.08	99.57	99.72

Tabela .4.3 - planifikimi dhe realizimi i shpenzimeve - Buxheti Komunal
Janar-Dhjetor/ 12

Nr	Pershkrimi	Pl.Vjetor 2012	Alok.2012	Shpenzimi vjetor 2012	% ndaj planit	% ndaj alok
1	Paga dhe Mëditje	6,020,080.15	6,020,080.15	6,014,799.41	99.91	99.91
2	Mallra dhe Shërbime	851,179.42	851,012.63	794,447.82	93.33	93.35
3	Shpenzimet e Sherb.Komunale	172,904.00	172,904.00	172,473.75	99.75	99.75
4	Subvencionet	175,774.00	175,774.00	169,784.04	96.59	96.59
5	Shpenzimet Kapitale	3,132,362.09	3,132,362.09	2,772,778.55	88.52	88.52
	Raporti përmbledhës	10,352,299.66	10,352,132.87	9,924,283.57	95.87	95.87



Tabelat 4.4.1 , 4.2 .paraqesin zhvillimin e buxhetit Komunal lidhur me shpenzimet sipas Sektorëve kryesor nga aspekti funksional, ndërsa në aspektin ekonomik sipas kategorive kryesore ekonomike të shpenzimit ; ndërsa tabela 4.3 pasqyron përmbledhjen e të dhënave për zhvillimin e buxhetit komunal sipas kategorive kryesore ekonomike të shpenzimeve .

Nëse bëjmë krahasimin në mes të objektivit (10.352.299.66 €) dhe realizimit (9.924.283.57 €) verehet se për vitin raportues Objektivi për shpenzimet është realizuar 96.83 %. Kur bëjmë krahasimin e shpenzimeve në mes të vitit raportues me një vit më parë, verehet se kemi një rritje të shpenzimeve për + 3.60 %.

Kur bëjmë krahasimin e kategorive kryesore ekonomike të shpenzimeve të vitit 2012 me një vit më parë, do të kemi këtë gjendje :

1. Kategoria e shpenzimeve paga dhe mëditje ka patur rritje për: + 3.25 %;
2. Kategoria e shpenzimeve për mallra dhe shërbime poashtu ka pasur rritje për: + 10.12 %
3. Shpenzimet e shërbimeve komunale kan patur një rritje + 14.94 %;
4. Subvencionet - Transferet kan patur rritje prej: + 25.65 % dhe
5. Kategoria e shpenzimeve kapitale ka patur rritje për : + 6.30%

Edhe pse të gjitha faturat e paraqitura për pages janë paguar në afatin ligjor , kemi fatura të mbetura për pagesë si bartje në buxhetin e vitit 2013. Faturat e pa paguara janë si rezultat i rjedhës së shpenzimeve për muajt nëntor dhe dhjetor, kryesisht si shpenzime të shërbimeve komunale, të cilat janë pranuar për pagesë nga programet pas mbylljes së sistemit të pagesave nga ana e Departamentit të Thesarit - MF.

Shuma e faturave të pa paguara për të gjitha programet e të bartura për pages me buxhetin e vitit 2013 është: 97.138.81 €.

Numri i të punësuarve me buxhetin e vitit 2012 ka qenë i paraparë në nr.1.307 p, dhe kryesisht është rrespektuar përveq në Sektorin e Arsimit ku ka patur levizje periodike për shkak të naturës së punës.

Kur është fjala të detyrimet kontigjente gjatë vitit 2012 komuna ka paguar gjithësejt mmjete në shumë prej : 19.620.00 €.



Kryetari I Komunës

Nexhat Demaku